

**VENDIM**  
**Nr.541, date 27.7.2011**

**PER DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.1114, DATE 30.7.2008 TE KESHILLIT TE**  
**MINISTRAVE "PER DISA CESHTJE NE ZBATIM TE LIGJEVE NR.7703, DATE 11.5.1993**  
**"PER SIGURIMET SHOQERORE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE", TE NDRYSHUAR,**  
**NR.9136, DATE 11.9.2003 "PER MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TE DETYRUESHME**  
**TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE NE REPUBLIKEN E**  
**SHQIPERISE", TE NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATE 13.10.1994 "PER SIGURIMET**  
**SHENDETESORE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE", TE NDRYSHUAR"**

Ne mbeshtetje te nenit 100 te Kushtetutes, te ligjit nr.7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, dhe te ligjit nr.7870, date 13.10.1994 "Per sigurimet shendetesore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, me propozimin e ministrit te Financave, Keshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Ne vendimin nr.1114, date 30.7.2008 te Keshillit te Ministrave, te ndryshuar, behen keto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 e kreut II, ndryshohet, si me poshte vijon:

"2. Paga minimale mujore, per efekt te llogaritjes se kontributeve te sigurimeve, shoqerore e shendetesore, nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, te jete jo me pak se 17 540 (shtatembdhjete mije e peseqind e dyzet) leke, ndersa paga maksimale mujore te jete 87 700 (tetedhjete e shtate mije e shtateqind) leke.

Per te punesuarit, marredheniet e punes te te cileve rregullohen me ligjin nr.7961, date 12.7.1995 "Kodi i punes ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, paga minimale mujore per llogaritjen e kontributeve, eshte ajo e percaktuar nga Keshilli i Ministrave, ne zbatim te nenit nr. 111 te ligjit te siperpermendur, e cila nuk mund te jete me e ulet se paga minimale, e percaktuar ne paragrafin e pare te kesaj pike."

2. Pikat 1, 2, 6, 7, 9, 10, 11 e 13 te kreut III, ndryshohen, si me poshte vijon:

"1. Shuma minimale mujore e kontributeve, per te gjitha deget e sigurimit, per periudhen nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, te jete 4 894 (kater mije e teteqind e nentedhjete e kater) leke.

Kontributi minimal mujor, sipas degeve te" sigurimit, te jete:

	ne %	ne leke
Dega e sigurimit te semundjeve	0.3	52;
Dega e sigurimit te barreindjeve	1.4	246;
Dega e sigurimit te pensioneve	21.6	3 790;
Dega e sigurimit te aksidenteve dhe semundjeve profesionale	0.3	52;
Dega e sigurimit te papunesise	0.9	158;
Sigurimet shendetesore	3.4	596.

2. Shuma minimale mujore e kontributit te sigurimit shendetesor per te vetepunesuarin dhe per pjesetaret e familjes, te patrajtuar me page, te jete 7 per qind e pages minimale mujore, e barabarte me 1 228 (nje mije e dyqind e njezet e tete) leke.

6. I vetepunesuari, i vetepunesuari ne ortakeri, i vetepunesuari qe puneson te trete (me perjashtim te te vetepunesuarit ne bujqesi), duke filluar nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, paguan per vete nje kontribut te detyrueshem per sigurimet, shoqerore dhe shendetesore, ne masen 30 per qind (23 per qind sigurim shoqeror dhe 7 per qind sigurim shendetesor) te pages mujore minimale prej 17 540 (shtatembdhjete mije e peseqind e dyzet) lekesh, te barabarte me 5 262 (pese mije e dyqind e gjashtedhjete e dy) leke ne muaj.

7. I vetepunesuari, per pjesetaret e familjes se tij mbi 16 vjec, qe nuk trajtohen me page, por qe punojne e bashkejetojne me te ligjerisht (me perjashtim te te vetepunesuarit ne bujqesi), duke filluar nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, paguan kontribut te detyrueshem per sigurimet, shoqerore dhe shendetesore, ne masen 30 per qind (23 per qind sigurim shoqeror dhe 7 per qind sigurim shendetesor) te pages mujore minimale prej 17 540 (shtatembdhjete mije' e peseqind e dyzet) lekesh, te barabarte me 5 262 (pese mije e dyqind e gjashtedhjete e dy) leke ne muaj.

9. Personat e vetepunesuar ne veprimtari, tregtare apo sherbimi, ambulante, nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, te deklarojne dhe te paguajne kontribut minimal mujor ne shumen 1 800 (nje mije e teteqind) leke.

10. Personat mbi 16 vjec, me te ardhura te rregullta nga pronesia e qe nuk jane te punesuar diku tjeter, duke filluar nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, te paguajne kontribut vetem per sigurimin shendetesor, ne masen 7 per qind te pages mujore minimale, prej 17 540 (shtatembdhjete mije e peseqind e dyzet) lekesh.

11. Te vetepunesuarit ne bujqesi, nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, te derdhin kontribut vjetor, per sigurimet shoqerore, ne masen 21 600 (njezet e nje mije e gjashteqind) leke, me perjashtim te te vetepunesuarve qe banojne ne rrethet: Buiqize, Diber, Gramsh, Has, Kolonje, Kukes, Librazhd, Malesi e Madhe, Mat, Mirdite, Puke, Skrapar, Tepelene dhe Tropoje, per te cilet masa e kontributit vjetor eshte 14 040 (katermbdhjete mije e dyzet) leke.

13. Kontributi i detyrueshem per sigurimet shoqerore, per personat qe punojne si punetore shtepie, nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, te jete 1 800 (nje mije e teteqind) leke ne muaj."

3. Pika 6 e kreut IV, ndryshohet, si me poshte vijon:

"6. Mbeshtetur ne ligjin nr.10 418, date 21.4.2011 "Per legalizimin e kapitalit dhe faljen e nje pjese te borxhit tatimor e doganor", te vetepunesuarit ne bujqesi paguajne kontributet per sigurimet shoqerore e shendetesore, per vitin ne vazhdim, pasi te kene shlyer detyrimet e papaguara per sigurimet shoqerore, qe nga data 1.1.2009.

Te vetepunesuarit ne bujqesi, te cilet nuk arrijne te plotesojne kushtin minimal te vjetersise ne pune, per te perfituar pension te pjesshem sipas dispozitave te ligjii nr.7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, mund te kryejne pagesa kontributesh pas plotesimit te moshes per pension, por me kusht qe ato t'u korrespondojne periudhave para plotesimit te moshes per pension dhe te mos jete caktuar ende asnje lloj pensioni."

4. Kreu VIII ndryshohet, si me poshte vijon:

"VIII. SHUMA BAZE E PERFITIMEVE

1. Ne mbeshtetje te neneve 2, 32, 36, e 48 te ligjit nr.7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, shuma baze e perfitimit, nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, te jete 11 117 (njembdhjete mije e njeqind e shtatembdhjete) leke ne muaj.

2. Ne mbeshtetje te nenit 96 te ligjit nr.7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, shuma e perfitimit, per personat, qe nuk plotesojne kushtet per perfitimin e mases se pensionit, te percaktuar ne paragrafm e pare te ketij neni, nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, te jete 7 468 (shtate mije e katerqind e gjashtedhjete e tete) leke ne muaj.

3. Ne mbeshtetje te pikes 3 te nenit 27, te pikes 2 te nenit 59, dhe te nenit 60 te ligjit nr.7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, baza e vleresuar mujore per efekt te llogaritjes se te ardhurave per barreindje, per rastet kur e drejta e perfitimit ka lindur, por perfituesja nuk ka page gjate gjithë muajve te vitit te fundit kalendarik, llogaritet duke bashkuar shumen e pagave faktike per muajt qe eshte derdhur kontribut per sigurimet shoqerore, me shumen e pagave minimale te percaktuara per efekt te derdhjes se kontributit te sigurimit shoqeror per muajt pa kontribut, pjesetuar me 12 muaj.

4. Ne mbeshtetje te pikes 4 te nenit 27 te ligjit nr.7703, date 11.5.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, shuma baze e perfitimit per grate, te cilat e kane periudhen e fundit te sigurimit si te vetepunesuara ne bujqesi, nga data 1.7.2011 e ne vazhdim, te jete 7 468 (shtate mije e katerqind e gjashtedhjete e tete) leke ne muaj."

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.7.2011.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Botuar ne F.Zyrtare 104 / 2011  
Dale nga shtypi me 04.08.2011